



Prishtinë, 28.01.2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1101\_2019

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084),
- Dispozitat e Nenit 10.4 të Kodit të Rrjetit- Dispozitat e përgjithshme,
- Dispozitat e Nenit 10 dhe 11 të Doracakut të raportimit për sektorin e energjisë,
- Kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të Raportit të Derrogimeve të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, Rregullave të Tregut dhe Licencës së OST të datës 10.12.2018 të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT ),

në seancën e mbajtur me datë 28.01.2019, nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e KOSTT SH.A. për **Derrogimet e dispozitave të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, Rregullave të Tregut dhe Licencës së OST** si në arsyetimin dhe shtojcën e këtij vendimi.
- II. Dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, Rregullave të Tregut dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit mbesin në fuqi.

## Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 10.12.2018 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A., për derrogim në zbatimin e disa dispozitave nga Kodi i Rrjetit Kodit i Matjes, Rregullat të Tregut dhe Licenca e OST.
- KOSTT në dokumentin e dërguar për derrogim ka sqaruar se arsyet e kërkesës për derrogim të dispozitave ligjore të **Kodit të Rrjetit** janë:
  - **Kodi i Planifikimit Operativ, pengesat e sistemit të transmetimit, kërkesat për rezerva, kapacitetet interkonektive**, për të cilat kërkesa për derrogim është deri më **31.12.2019** dhe kjo është aprovuar nga Bordi i ZRRE-së;



- **Kodi i Balancit**, *dispeçimi në kohë reale, aranzhimet balancuese, dispeçimi në kushtet e pamjaftueshmërisë së furnizimit* – kërkesa deri më **31.12.2019** dhe kjo është aprovuar sipas kërkesës;  
*mospërputhja e ngarkesës me gjenerimin në kohë real* - kërkesa deri më **30.06.2019** dhe kjo është aprovuar sipas kërkesës;  
*rregullimin kohor* - kërkesa deri më **31.12.2019** dhe kjo është aprovuar sipas kërkesës;
- **Kodi operativ**, *Stabiliteti dhe Mbingarkesa e Rrjetit* - kërkesa deri më **30.06.2019** dhe kjo është aprovuar sipas kërkesës;  
*reduktimi nga nënfrekuenca, testimi i startimit nga errësira dhe testimet e sistemit* - kërkesa deri më **31.12.2019** dhe këto janë aprovuar sipas kërkesës;
- KOSTT ka kërkuar dhe arsyetuar edhe shtyrjen e përmbushjes së zbatimit të dispozitave të **Kodit të Matjes** në lidhje me *matjen e kapacitetit (fuqisë) dhe energjisë* - kërkesa deri më **31.12.2019** dhe kjo është aprovuar sipas kërkesës;
- Më tej KOSTT ka kërkuar derogim në zbatimin e dispozitave të **Rregullave të Tregut**, në lidhje me *alokimin dhe tregtimin e kapaciteteve interkonektive dhe nominimet interkonektive* për një periudhë deri në fillimin e implementimit të Marrëveshjes për Kyçje me ENTSO-E, ndërsa derogimi është lejuar për periudhë deri më **31.12.2019**;
- Me kërkesën e vet, KOSTT ka kërkuar edhe derogim (shtyrje të afatit në zbatimin e dispozitave të **Licencës së OST**) dhe ka sqaruar arsyet, në lidhje me *disponueshmërinë dhe mirëmbajtjen e të dhënave, blerjen ekonomike të asetëve, shërbimeve dhe shërbimeve ndihmëse dhe obligimet e sigurimit*, për një periudhë deri me **31.12.2019** dhe kjo është aprovuar sipas kërkesës;

Për pikat e kërkesës për derogime KOSTT ka sqaruar se arsyet kryesore të pamundësisë së implementimit të dispozitave të përmendura janë mosfunksionimi i KOSTT si zonë/bllok rregullues, pamundësia e sigurimit të rezervave për shërbime ndihmëse që po ashtu lidhet me arsyen e parë, si dhe arsye tjera teknike/financiare.

Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës sipas Raportit të Derrogimeve të dispozitave të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, Rregullave të Tregut dhe Licencës së OST ka vendosur si në diapozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund ti drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së,**

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejriqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi së bashku me Raportin e derogimeve me afatet e lejuara iu dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së